USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Ideal Zhaveli

Drejtor Ekzekutiv në Activism Roots

Kam filluar aktivizimin tim në komunitet qysh kur kam qenë në shkollë të mesme duke u angazhuar në aktivitete vullnetare me organizata të ndryshme në Gjakovë. Pas përfundimit të shkollës së mesme, kam vazhduar studimet në Universitetin e Evropës Juglindore në drejtimin Shkencat Politike. Në vitin e dytë të studimeve fitova bursën Erasmus dhe vazhdova studimet në Universitetin e Lubjanës në Slloveni. Pasi përfundova studimet e nivelit baçelor, vazhdova tutje angazhimin tim si aktivist me organizata joqeveritare në Gjakovë.

Në vitin 2018 u emërova Kryetar i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL) në Gjakovë. Këshillin e kam udhëhequr për pothuajse katër vite. Sukseset që arrita në krye të KVRL-së erdhën si rezultat i angazhimeve të përbashkëta me anëtarët e tjerë, me të cilët bashkarisht e kthyem KVRL-në në Gjakovë si njërën prej degëve më aktive në Kosovë për katër vite me rradhë. Arritëm numrin më të madh të vullnetarëve duke sjellur projekte të shumta për zhvillimin e të rinjve, dhe komunitetit në përgjithësi. Bashkëpunimet me organizata ndërkombëtare si Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) e United States Agency for International Development (USAID) ishin të vazhdueshme dhe i sollën shumë projekte rinisë së Gjakovës.

Tani, së bashku me disa aktivistë, kemi themeluar organizatën Activism Roots duke synuar ta sjellim një qasje ndryshe për promovimin dhe zhvillimin e qytetarisë aktive në Kosovë.

#dikurjashehhajrin #hajri #jashehhajrin

Iniciativa "Dikur ja sheh hajrin" në Gjakovë mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes aktivitetit Up to Youth.

Up to Youth është aktivitet pesë vjeçar i përkushtuar që të përmirësojë kapacitetet e rinisë dhe të krijojë mundësi për aspiratat e rinisë, në mënyrë që ata të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga komunitete më të qëndrueshme, më demokratike dhe më prosperuese.

Përmbajtja është përgjegjësi e Global Communities dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.